



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i  
Tehnologija--Ministry of Education Science and Technology*

Kabineti i Ministrit/Cabinet of the Ministry/Kabinet Ministra/

Numër: 257/01B  
Datë: 09/02/2018

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 4 paragrafi 4.2 të Ligjit nr. 02/L-67 për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik, si dhe duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të nenit 20 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011), nxjerr:

#### V E N D I M

#### Për emërimin e Këshillit të ekspertëve për programe dhe tekste shkollore

1. Emërohet lista e Këshillit të ekspertëve për programe dhe tekste shkollore me këtë përbërje:

- 1.1. Ferim Gashi, kryetar;
- 1.2. Fatmir Bytyqi, zëvendëskryetar;
- 1.3. Shkodran Imeraj, anëtar;
- 1.4. Agim Berdynaj, anëtar;
- 1.5. Fehat Podvorica, anëtar;
- 1.6. Arbnora Dushi, anëtar;
- 1.7. Boris Scharlowski, anëtar;
- 1.8. Eda Vula, anëtare;
- 1.9. Fatime Jasiqi, anëtare;
- 1.10. Arbnesha Mexhuani, anëtare;
- 1.11. Fehmi Krasniqi, anëtar;
- 1.12. Feime Llapashtica, anëtare;
- 1.13. Jusuf Thaci, anëtar;
- 1.14. Luan Tetaj, anëtar;
- 1.15. Sefer Avdiaj, anëtar;
- 1.16. Shkelqim Millaku, anëtar;
- 1.17. Valbona Mjeku- Feti, anëtare.



2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit të ekspertëve të programeve dhe teksteve shkollore janë:

2.1. Planifikon procesin e përgatitjes së teksteve të reja shkollore, bazuar në programet kurrikulare për klasë dhe lëndë të caktuara.

2.2. Mbikëqyrë zbatimin e standardeve për tekste shkollore nga autorët e teksteve dhe shtëpitë botuese.

2.3. Propozon përmbajtjen e konkursit për tekste të reja sipas Kurrikulës së Re.

2.4. Propozon konkursin për zgjedhjen e recensentëve për vlerësimin e dorëshkrimeve sipas konkursit nga pika 2.3 e këtij vendimi.

2.5. Themelon ekipet e recensentëve për lëndë dhe fusha të caktuara kurrikulare, shqyrton raportet e recensentëve dhe aprovon ato.

2.6. Mbështet planin dhe programin e trajnimit për autorët e teksteve shkollore dhe shtëpitë botuese.

2.7. Krijon mekanizmin për mbledhjen e vazhdueshme të të dhënave nga shkollat/komunat lidhur me cilësinë e teksteve shkollore për të identifikuar mangësitë eventuale të teksteve dhe nevojën për përmirësim.

2.8. Shqyrton dhe aprovon raportet nga autorët e teksteve shkollore dhe shtëpitë botuese për tu siguruar se, tekstet janë përmirësuar sipas kërkesave dhe propozimeve të dëshmuara me fakte nga shkollat.

3. Organizimi i punës, funksionimi, përgjegjësitë specifike, parimet dhe rregullat e punës, përcaktohen me Rregullore të brendshme të punës së Këshillit.

4. Këshilli i ekspertëve të programeve dhe teksteve shkollore do të ketë përkrahje teknike dhe operative nga Divizioni për Planprograme dhe Tekste Shkollore që është Sekretaria e Këshillit si procesmbajtëse.

5. Këshilli i ekspertëve të programeve dhe teksteve shkollore për punën e tij, i raporton në baza periodike dhe sipas kërkesës, ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

6. Shfuqizohen vendimet paraprake për emërimin e anëtarëve të Këshillit të ekspertëve të programeve dhe teksteve shkollore të MASHT.

7. Kompensimi i anëtarëve të Këshillit të ekspertëve të programeve dhe teksteve shkollore, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e lartshënuara si dhe nevojës për emërimin e Këshillit të ekspertëve për programe dhe tekste shkollore, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Vendimi u dërgohet:

1. Anëtarëve të Këshillit;
2. Kabinetit të Ministrit;
3. Sekretarit të përgjithshëm të MASHT;
4. Arkivit të MASHT;



Shyqiri Bytyqi,

Ministër